



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

EmriGjykates

Numri i lëndës: 2020:176006

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05458616

Ac.nr.5988/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit D Sh.P.K, me numër biznesi 811168146, me seli në fshatin S, Komuna e G., të cilin e përfaqëson J.P, kundër debitorit N.P.N. “H”, me numër biznesi 811307695, me adresë në Prizren, me pronar B.K.H të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.G nga Prishtina, për pagesë borxhi, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.949/2020, të datës 15.04.2022, me datë 15.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbartimore dhe lënda t’i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë–Dhomave të Shkallës së Dytë, si gjykatë kompetente në pikëpamje lëndore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin PPP.nr.949/2020, të datës 15.04.2022, në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbartimit N.P.N. “H”, me adresë në Prizren, me pronar B.K.H ushtruar kundër urdhrit për përmbartim, P.nr.1096/2020 të datës 20.11.2020, të përmbartuesit privat F Sh nga Peja dhe mbetet në fuqi i njëjti urdhër për përmbartim.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë debitori N.P.N. “H”, me numër biznesi 811307695, me adresë në Prizren, me pronar B.K.H me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit kreditorit, të anulohet aktvendimi PPP.nr.949/2020, të datës 15.04.2022, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në shkallën e parë.

Kreditori nuk na parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera të lëndës,

në mbështetje të dispozitës së nenit 29, 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se, në nenin 13 par.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale të Kosovës, është përcaktuar: “ *Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: pika 1.1 “kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*”, ndërsa paragrafi 6 i nenit 13 i të njëjtit ligj përcakton: “*Dhomat e shkallës së dytë janë kompetente për të trajtuar: pika 6.1, “ të gjitha ankesat ndaj vendimeve të dhomave të shkallës së parë brenda kompetencave të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni”*”, andaj referuar këtyre dispozitave ligjore dhe duke qenë se palët ndërgjyqëse në këtë procedurë janë shoqëri tregtare, për vendosje në këtë çështje juridike përmbarimore, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Dytë.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 29 dhe 208 të LPK-së, e lidhur me nenin 13 par.1 pika 1.1 dhe par.6 pika 6.1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr.08/L-015.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5988/22, datë 15.03.2024

G j y q t a r i,
Ylber Shurdhiqi